



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA ELBASAN

Nr. \_\_\_\_\_ prot.

Elbasan, më \_\_\_\_\_.\_\_\_\_.2022

**LËNDA:** Dërgim njoftimi për botim në Buletinin e Prokurimit Publik.

AGJENCISË së PROKURIMIT PUBLIK

**TIRANË**

FORMULARI I NJOFTIMIT TE FITUESIT (PARAPRAK)

Nga: **Bashkia Elbasan** adresa: rruga “Qemal Stafa”, Elbasan

Për: **“INSTANT.AL” sh.p.k.** me adresë: Tirane, Rruga Idriz Dollaku, Ali demi, Ap.2, shkalla 1, kati I.

**Procedura e prokurimit:** Procedurë e Hapur e Thjeshtuar.

**Numri i referencës së procedurës/lotit:** REF-47187-10-24-2022

**Përshkrim i shkurtër i kontratës:** “Mirembajtje dhe permiresimi i sistemit te taksave dhe finances”, me fond limit **1.083.333** (njëmilion e tetëdhjetë e tremijë e treqind e tridhjetë e tre) **lekë pa t.v.sh.**, vënë në dispozicion nga Buxheti i Bashkisë Elbasan.

Publikime të mëparshme (nëse aplikohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar ne kosto

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim

Me anë të kësaj bëjmë me dije se, në këtë procedurë /lot kanë marrë pjesë operatorët ekonomikë të mëposhtëm me vlerat përkatëse si më poshtë:

**1. “INSTANT.AL” shpk me Nipt: L 81506043 D**

Vlera e paraqitur në këtë procedurë është **850’000** (tetëqind e pesëdhjetëmijë) **lekë** (pa tvsh).

**2. “INFO BUSINESS SOLUTIONS” sh.p.k. me Nipt: L 02214022 G**

Vlera e paraqitur në këtë procedurë është **1’020’000** (njëmilion e njëzetmijë) **lekë** (pa tvsh).

**3. “OVLA SYSTEMS” sh.p.k. me Nipt: M 11423019 O**

Vlera e paraqitur në këtë procedurë është **1'007'499** (një milion e shtatë mijë e katërqind e nëntëdhjetë e nëntë) **lekë** (pa tvsh).

Nga pjesëmarrësit janë skualifikuar Ofertuesit e mëposhtëm:

**1. “Ovla Systems” sh.p.k. me Nipt: M 11423019 O s’kualifikohet për arsyet e mëposhtme:**

Në përmbushje të kapacitetit ekonomik dhe financiar, kushti 2.2.2 : Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore, për vitet financiare 2020 dhe 2021 të shoqëruara me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabël të Autorizuar, në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve ne perputhje me Ligjin nr.10091, date 05.03.2009 "Per auditimin ligjor, organizimin e profesionit te ekspertit kontabel te regjistruar dhe te kontabilistit te miratuar", i ndryshuar, Kreu V, neni 41, pika c. Kjo kërkesë konsiderohet e përmbushur nëse në dy bilance të njëpasnjëshme, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Operatori Ekonomik në përmbushje të këtij kriteri, bilancet për vitet 2020-2021, nuk plotëson kushtin.

Ne LPP nr.162, date 23.12.2020, " Për Prokurimin Publik", neni 92, pika 3, parashikohet se : Autoriteti ose Enti Kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe me dokumentet e tenderit pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji.

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë subjektin: **“INSTANT.AL” sh.p.k** me adresë: Tirane, Rruga Idriz Dollaku, Ali demi, Ap.2, shkalla 1, kati I, se oferta e paraqitur, me një vlerë totale prej **850'000** (tetëqind e pesëdhjetë mijë) **lekë (pa tvsh)**, është identifikuar si fitues (paraparak) i procedurës së prokurimit.

Me publikimin e këtij njoftimi, fillojnë afatet e ankimit sipas përcaktimeve në nenin 109 të Ligjit Nr. 162/2020, datë 23.12.2020, “Për Prokurimin Publik”.

**TITULLARI I AUTORITETIT KONTRAKTOR  
PERSONI I AUTORIZUAR PREJ TIJ  
ZV.KRYETARI  
Aulona Bylykbashi**